



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Komisioni Disiplinor - Disciplinska Komisija - The Disciplinary Committee

Nr.03/2014

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Bajram Miftari - kryesues, Mahir Tutuli - anëtar dhe Valdrin Beka - anëtar, në çështjen juridike disiplinore të përmbaruesit privat [REDACTED], i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367, pika 1, paragrafi 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të dt. 29.07.2015, dhe asaj të datës 15.10.2015, ku ishin të pranishëm: përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, Departamentit për Profesione të Lira, Labinot Gashi, në cilësinë e propozuesit për fillimin e procedurës disiplinore; dhe personalisht përmbaruesi privat, në cilësinë e të dyshuarit për shkelje disiplinore, si dhe pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të datës 15.10.2015, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. [REDACTED] përmbaruesi privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], ËSHTË PËRGGJEGJËS për shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, siç është përshkruar në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, nr. 03/2014, të datës 26.02.2015.
2. Për shkeljen disiplinore të kryer i shqiptohen masat disiplinore: gjobë në të holla në shumën prej 3,000.00 € (Tremijë Euro), dhe vërejtje publike.
3. Detyrohet përmbaruesi privat, z. [REDACTED] që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej tre muajsh, duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi, përmbaruesit privat.
4. Në emër të shqiptimit të vërejtjes publike, përmbaruesit i tërhiqet vërejtja në mënyrë publike për shkeljet e bëra në procedurë përmbarimore, dhe që në të ardhmen të jetë

në nivel më të lartë të përgjegjësisë dhe profesionalizmit, në mënyrë që të mos përsëriten sjellje të këtilla apo të ngjashme. Detyrohet Ministria e Drejtësisë që këtë vërejtje publike ta publikoj në faqen zyrtare të internetit të saj, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij vendimi.

### Arsyetimi

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: *Ministria*), me datën 26.02.2015, ka paraqitur propozim pran Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat (në vazhdim të tekstit: *Komisioni*) për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat [REDAKTUAR] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR], për shkak të dyshimit se në lëndën përmbaimore të udhëhequr pran zyrës së tij, P.nr.293/14, ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore.

Në propozim ndër të tjera është theksuar se me datën 10.10.2014, përfaqësuesja e autorizuar e shoqërisë tregtare “QMI”, sh.p.k, me parashtresën e datës 02.10.2014, i ka propozuar Ministrisë fillimin e procedurës disiplinore kundër përmbauesit privat [REDAKTUAR]. Ministria e ka shqyrtuar parashtresën e palës ankuese dhe ka ardhur në përfundimin se ka dyshime të bazuara se z. [REDAKTUAR] ka bërë shkelje disiplinore gjatë procedimit me lëndën përmbaimore nën udhëheqjen e tij, P.nr. 293/14, ku palë kreditore ka qenë Gruppo Vinicolo Fantinel, SPA, kurse palë debitore ka qenë “QMI”, sh.p.k.

Në propozimin e Ministrisë për fillimin e procedurës disiplinore, ndër të tjera është theksuar se përmbauesi privat në ekzekutimin e lëndës përmbaimore nr. 293/14, ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore (në vazhdim të tekstit: *LPP*). Në propozim, më tutje është theksuar se përmbauesi privat me dt. 26.09.2014, ka zbatuar përmbaimin, por pa marrë urdhër tjetër për përmbaim, me datën 29.09.2014, është paraqitur përsëri në objektin e QMI-së, për të zbatuar përsëri përmbaimin tashmë të kryer me dt. 26.09.2014, me të cilat veprime përmbauesi ka treguar njëanshmëri dhe se përmbaimi i kryer nga ana e tij, me dt. 29.09.2014, është i kundërligjshëm. Me propozimin e lartcekur, i është propozuar *Komisionit* që të zhvillohet procedura disiplinore, të administrohen provat e lëndës dhe t’i shqiptohet përmbauesit masa disiplinore adekuate, konform nenit 368 të LPK-së. Propozimit të Ministrisë i është bashkëngjitur parashtresa e palës ankuese (“QMI”, sh.p.k) dhe provat e lëndës.

Me datën 28.04.2015, Komisioni i ka dërguar njoftimin me shkrim përmbauesit se Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Profesionet e Lira, me dt. 27.02.2015, ka paraqitur pran Komisionit Disiplinor, propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tij, për shkak të dyshimit të bazuar se ka bërë shkelje disiplinore në lëndën përmbaimore, P.nr.293/14. Me të njëjtën parashtresë Komisioni e ka njoftuar përmbauesin se ka të drejtë që të deklarohet me shkrim në adresën e Komisionit Disiplinor, brenda afatit prej 15 ditësh, konform nenit 3.9 të Udhëzimit Administrativ MD-nr.09/2014, për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbauesit

Privat (të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me dt. 13.05.2014). Po ashtu, përmbaruesi është njoftuar se parashtresa mund të përmbajë të dhënat dhe opinionin e tij lidhur me përgjegjësinë disiplinore, dhe se mund të paraqes fakte dhe argumente për të mbështetur pozitën ligjore të tij. Bashkëngjitur me njoftimin, i është dorëzuar një kopje e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore dhe e shkresave të tjera të lëndës.

Me parashtresën e dt. 10.07.2015, drejtuar Komisionit, përmbaruesi ka theksuar se nuk e ndien veten përgjegjës dhe se në ekzekutimin e rastit përmbarimor ka vepruar ashtu siç ka qenë përgjegjës me titullin përmbarimor. Parashtresës i'a ka bashkëngjitur një mori provash, të listuara si në shkresat e lëndës.

Me dt. 29.07.2015, komisioni ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë qenë të pranishëm, propozuesi (Ministria) i përfaqësuar nga zyrtari ligjor Labinot Gashi dhe personalisht përmbaruesi [REDAKTUAR]. Seanca disiplinore është vazhduar me datën 15.10.2015, me pjesëmarrjen e të dy palëve në procedurë. Në seancë dëgjimore, propozuesi (Ministria), ka deklaruar se mbetet në tërësi pran propozimit për fillimin e procedurës disiplinore dhe për shqiptimin e masës disiplinore adekuate, ndaj përmbaruesit. Nga ana tjetër, përmbaruesi ka theksuar se konsideron se të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e tij kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe me aktgjykimin si titull përmbarimor.

Me qëllim të konstatimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit nëse ka apo nuk ka shkelje disiplinore, Komisioni ka bërë administrimin e provave të lëndës, përmes leximit dhe analizimit të tyre, si në vijim: Parashtresa e përfaqësueses së QMI, avokates Shpresa Rexhepi, me emërtimin kërkesë mbi ligjshmërinë e punës së përmbaruesit privat e datës 10.10.2014; aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C.nr.424/2009, i dt.11.06.2012; aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.391/21 i dt.18.02.20014; propozimi për caktim përmbarimi i dt.05.05.2014, i paraqitur nga kreditori Gruppo Vinicolo Fantinel, kundër debitorit QMI, sh.p.k; aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, E.nr.691/2014 i dt.25.07.2014; Dy konkluzionet e lëshuara nga përmbaruesi privat, P.nr.293/2014, të dt.23.09.2014; procesverbali i hartuar nga përmbaruesi privat me datën 26.09.2014; procesverbali i hartuar nga përmbaruesi privat, i datës 29.09.2014; autorizimi për avokaten Shpresa Rexhepi; ankesa e datës 02.10.2014, e paraqitur nga avokatja Shpresa Rexhepi; certifikata e regjistrimit të biznesit për Agrokosova Holding sh.p.k. me informatat për biznesin; statuti i Agrokosova Holding sh.p.k; parashtresa e përmbaruesit privat e datës 24.09.2009, me emërtimin kërkesë për sigurimin e patrollës së policisë; parashtresa për përfundimin e procedurës përmbarimore në emër të kreditorit, e paraqitur me 29.09.2014, nga përmbaruesi privat; imeli i datës 28.09.2014; dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR] PP.nr.4/2014, Dega në Suharekë, i datës 13.10.2014. Po ashtu, në seancën e dëgjimore të datës 15.10.2015, janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve Bujar Alijaj dhe Faton Alijaj.

Pas dëgjimit të palëve në procedurë si dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave të lëndës, Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

- Me datën 22.09.2014, përmbauesi e ka pranuar nga Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, lëndën përmbaimore, E.nr. 691/14, të kreditorit Gruppo Vinicolo Fantinel, SPA, ndaj debitorit "QMI", Sh.p.k, që të dy subjektet aksionarë të Shoqërisë Tregtare "Agrokosova Holding", sh.p.k, e cila lëndë pranë zyrës përmbaimore ka marrë shenjën, P.nr. 293/14.
- Si titull përmbaimore për ekzekutim nga kjo lëndë përmbaimore ka qenë aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C.nr.424/09, i datës 11.06.2012, gjegjësisht pjesa "I" e dispozitivit të tij, i cili aktgjykim, në atë pjesë është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.391/2012, të datës 18.02.2014, dhe si i tillë, në atë pjesë është bërë i formës së prerë dhe i plotëfuqishëm. Me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht në pjesën "I" të dispozitivit të tij, është përcaktuar si në vijim:

*Detyrohet debitori që kreditorit t'i lejoj qasjen në ushtrimin e të drejtave të tij qeverisëse, të aksioneve dhe pronësore, të përcaktuara me ligj, Statut dhe Marrëveshje të Shoqërisë, në "Agrokosova Holding", sh.p.k, si aksionar i saj.*

- Me konkluzionin e datës 23.09.2015, përmbauesi ka vendosur dhe ka njoftuar palët se me datën 26.09.2014, do të ndërmarr veprimet ekzekutive sipas titullit përmbaimore. Në datën e caktuar (26.09.2014) përmbauesi ka ndërmarrë veprime ekzekutive nga kjo lëndë përmbaimore, ashtu që, ka dalë në ekzekutim në terren dhe ka bërë të mundur hyrjen e përfaqësuesve të kreditorit në lokalet e "Agrokosova Holding".
- Me datën 29.09.2014, përmbauesi ka ndërmarrë përsëri veprime ekzekutive, në lokalet e "Agrokosova Holding". Komisioni ka vlerësuar se veprimet ekzekutive të ndërmarra nga përmbauesi privat me dt. 29.09.2015, janë manifestuar me shkelje të shumta ligjore. Përkundër asaj se përmbauesi privat me dt. 26.09.2015, ka konstatuar në procesverbal se është bërë zbatimi i përmbaimit, me dt. 29.09.2014 ka ndërmarrë përsëri veprime ekzekutive, madje pa nxjerrë paraprakisht konkluzion për caktimin e veprimit ekzekutiv dhe pa e lajmëruar debitorin. Përveç kësaj, përmbauesi i ka tejkalluar autorizimet e përcaktuara me aktgjykim – si titull ekzekutiv dhe me aktvendimin për caktim përmbaimit. Është provuar me provat e administruara dhe është pohuar nga përmbauesi, se me dt. 29.09.2014, përmbauesi ka nxjerrë nga objekti ku zhvillon veprimtarinë "Agrokosova Holding", gjithë stafin e debitorit. Komisioni nuk e ka pranuar si arsye të mjaftueshme pretendimin e përmbauesit se për të mundur realizimin e të drejtave të kreditorit në qeverisjen e shoqërisë tregtare, është dashur të bëhet zbrazja e paluajtshmërisë. Titulli përmbaimore dhe aktvendimi për caktim përmbaimit nuk ka kërkuar zbrazjen e paluajtshmërisë, por mundësimin e kreditorit që të ushtroj të drejtat e tij qeverisëse si bashkë aksionar. Detyrimi i debitorit ka qenë lejimi i qasjes së kreditorit në ushtrimin e të drejtave të tij qeverisëse, pra, detyrim për durim apo mosveprim. Ligji për Procedurën

Përmbartimore ka ofruar mënyra dhe mekanizma për ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre. Me nenin 294 të LPP-së, është përcaktuar se:

*Në qoftë se debitori është i detyruar ta duroj kryerjen e ndonjë veprimi, ose të përmbahet nga kryerja e veprimit, organi përmbartues sipas propozimit të kreditorit që pretendon se debitori vepron në kundërshtim me detyrimin e tij, me aktvendim apo urdhër e urdhëron debitorin që të sillet në pajtim me detyrimin që e ka dhe e kërcënon me gjobë në të holla.*

Komisioni vlerëson se përmbartuesi privat në mënyrë të gabuar ka anashkaluar këtë dispozitë ligjore. Më tutje, përmbartuesi privat, ka zbatuar dispozitat nga Kreu XII të LPP-së, që kanë të bëjnë me zbrazjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, përkundër faktit se titulli përmbartimor dhe aktvendimi për caktim përmbartimi nuk kanë përcaktuar një gjë të tillë.

Me nenin 365 të LPP-së është përcaktuar se përmbartuesi privat ka përgjegjësi disiplinore nëse me veprimet e tij në ushtrimin e veprimtarisë së vetë shkel dispozitat e këtij ligji dhe të dispozitave tjera, nëse nuk i plotëson detyrimet e parapara me statut dhe me akte tjera të Odës, dhe nëse shkel prestigjin e profesionit të përmbartuesit privat.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Komisioni ka ardhur në përfundimin se përmbartuesi privat me veprimet e ndërmarra, të përshkruara si më sipër, ka kryer shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi. 1.2, të LPP-së, ku është përcaktuar se:

*Nëse përmbartuesi privat gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij, nuk i përmbahet ligjit, mund të shkaktoj shkelje disiplinore.*

Në individualizimin e masës disiplinore, Komisioni ka marrë për bazë rregullat e përcaktuara me nenin 368.4 të LPP-së, ku është përcaktuar se:

*Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore merren për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masave dhe atë posaçërisht: pesha dhe pasojat e shkeljes; dëmi i shkaktuar; shkalla e përgjegjësisë; dhe masat e mëhershme disiplinore.*

Në përcaktimin e masave disiplinore Komisioni ka marrë për bazë si rrethana lehtësuese: faktin se përmbartimi privat është profesion i ri në Kosovë; dhe faktin se përmbartuesi privat nuk është provuar se është subjekt i ndonjë mase të mëhershme disiplinore. Ndërsa si rrethana rënduese Komisioni ka gjetur se: përmbartimi ka prodhuar efekte negative financiare në veprimtarinë e përgjithshme të Shoqërisë “Agrokosova Holding”; dhe se përmbartimi i kryer me shkeljet e sipërmandura, ka dëmtuar imazhin e Shoqërisë “Agrokosova Holding”, si shoqëri tregtare. Fakti se veprimet ekzekutive përmbartimore janë përcjellur dhe publikuar në mediumet e vendit (megjithëse xhirimet janë bërë prej jashtë portave të hytjes së objektit e Shoqërisë), ka mundur të reflektoj edhe më shumë në imazhin e Shoqërisë Tregtare.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër Komisioni ka vendosur se përmbartuesi privat është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe përmbartuesit i ka shqiptuar masat disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi. Komisioni ka vlerësuar se masat e shqiptuara janë proporcionale me shkeljet e gjetura dhe me përgjegjësinë e përmbartuesit privat. Njëherit, Komisioni ka ardhur në përfundimin se zbatimi i këtyre masave disiplinore do të ketë efekt pozitiv në parandalimin e përmbartuesit që në

veprimtarinë e mëtejshme profesionale, të jetë më i kujdesshëm dhe më i përgjegjshëm në procedimin dhe zbatimin e lëndëve përmbarrimore, në përputhje me dispozitat ligjore që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

### KOMISIONI DISIPLINOR

Nr. 04/2014, me datën 15.10.2015

Kryesuesi i Komisionit Disiplinor

Bajram Miftari



UDHËZIMI JURIDIK: Vendimi i komisionit disiplinor është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritet konflikti administrativ (neni 374.5 i LPP-së).